



## AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR



Autorial nga:  
**Sabit Gashi**

**Raporti Special për  
Ndryshimet Klimatike**

**KPM ka aprovuar si të  
bazuar ankesën e  
ASHNA ndaj RTK-së**

**Janar – Korrik 2018 me  
reshje rekorde në 15  
vitet e fundit**

**ASHNA dhuron printer  
dhe fotokopje për  
institucionet edukativo  
arsimore**

**ASHNA shpërblen  
punëtorin e vitit z.  
Ramiz Latifi**

**SINKON  
pjesëmarrëse në  
punëtorinë e  
organizuar në  
Vjenë të Austrisë**



**Operimt Komercale Korrik–Shtator  
7.0% rritje**

**ASHNA ndihmon Kryeqytetin  
me të dhëna meteorologjike**



## Menaxhmenti i ASHNA-së për vizitë në Hungarocontol



Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) dhe Kryeqyteti i Kosovës Prishtina, nënshkruan Marrëveshje Mirëkuptimi në lidhje me ofrimin e të dhënave meteorologjike për këtë të fundit. Palët, përmes kësaj

marrëveshje u dakorduan që në vazhden e përpjekjeve për adresimin e ndotjes së ajrit në Prishtinë, Departamenti Meteorologjik i ASHNA-së do t'i dërgojë Drejtorisë së Administratës së Prishtinës të dhënat

meteorologjike në baza të rregullta kohore. Nga këto të dhëna Kryeqyteti do të përfitojë përmes njoftimit të publikut se kur pritet të ketë stagnim të lëvizjes së masave ajrore, rrjedhimisht rritje të ndotjes së ajrit në Prishtinë.

Marrëveshja u nënshkrua nga Menaxheri i Departamentit Meteorologjik në ASHNA, Sherif Gosalci dhe Nënkryetari njëherit Drejtor i Drejtorisë së Administratës i Kryeqytetit Muhedin Nushi.

## KPM ka aprovuar si të bazuar ankesën e ASHNA ndaj RTK

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), ka aprovuar si të bazuar ankesën e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), kundër Radio Televizionit të Kosovës RTK1, lidhur me kronikën "Siguria në ANP" e transmetuar me datë 02.02.2018 në

Lajmet qendrore të RTK-së.

KPM me këtë rast, duke i dhënë të drejtë ASHNA-së, ka shqiptuar masën ndëshkuese (vërejtje), ndaj mediumit RTK1 për shkeljet të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

### Vendimi

11. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
12. Komisioni bazuar në nenin 30 paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me **Vërejtje**, për shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

### E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërishit relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


  
Muja PERAJI  
Kryetar



10.07.2018  
Datë



## Operimet Komeriale Korrik-Shtator, me rritje rreth 7.0%




Operimet e menaxhuara Komeriale TM3 2018

Gjatë tre mujorit të tretë të 2018, në Agjencinë e Shërbimeve të Navi-

gacionit Ajror janë realizuar gjithsejtë 5339 Operime Komeriale.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ku në bazë të statistikave

të numrit të operimeve për këtë periudhë e në të cilën janë realizuar gjithsejtë 5000 operime, vërehet një rritje e numrit të operimeve me rreth 7.0% apo 339 operime më shumë.



Operimet e Menaxhuara Komeriale Janar - Mars 2018

Ndërkaq në periudhën Janar - Shtator 2018 janë realizuar gjithsej 12760 operime komerciale, ku nëse krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar Janar - Shtator 2017, ku janë realizuar 11528 operime, kemi një rritje prej rreth 11%, apo 1232 operime më shumë.



Pranim dorëzimi i prinnterëve fotokopje

## ASHNA dhuron printer dhe fotokopje për institucionet edukativo arsimore

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) ka dhuruar 26 printer dhe fotokopje për institucionet edukativo arsimore të republikës së Kosovës.

Ky vendim për dhurimin e printerëve dhe fotokopjeve është marrë në bazë të kontratës së re të Autoriteti Qendror të Prokurimit, kontratë kjo e cila kë vënë jashtë përdorimit printerët dhe fotokopjet aktuale të ASHNA-së.

Për zgjedhja e institucioneve edukativo arsimore të cilat kanë përfituar printer dhe fotokopje është bërë nga ana e komisionit tre anëtarësh i përzgjedhur nga ASHNA-ja, ku si kriter gjatë shqyrtimit të kërkesave kanë qenë, nevoja për pajisje me printer/fotokopje si dhe numri i nxënësve të institucionit arsimor i cili ka parashtruar kërkesë.

Nga 26 institucione edukativo arsimore të cilat kanë përfituar printer dhe fotokopje nga dhurimi i ASHNA-së, prej tyre 4 shkolla kanë qenë të mesme dhe 22 shkolla fillore, të cilat falënderuan ASHNA-në

dhe Drejtorin Bahri Nuredini për ndihmën e vazhdueshme për institucionet edukativo arsimore të Republikës

së Kosovës.

Vlen të theksohet se kjo nuk është hera e parë, pasi që edhe ne të

kaluarën ASHNA ka dhuruar pajisje tjera të Teknologjisë Informative për institucionet edukativo arsimore.

DORZIMI I FOTOKOPJEVE-PRINTER				
NR	SHKOLLA	FOTOKOPJE-PRINTER	NR.KONTAKT	NR.KODI
1	ILIRIA- PRSIHTINE	FOTOKOPJE-Xerox 5222	044-338-330	001596
2	IDRIZ BERANI	FOTOKOPJE-Xerox 5222	044-482-609	001597
3	ISMAIL DUMOSHI	FOTOKOPJE-Xerox 5222	049-678-797	1598
4	ILIR KONUSHEVCI	FOTOKOPJE-Xerox 5222	044-241-449	001599
5	DARDANIA-PRISHTINE	FOTOKOPJE-Xerox 5222	044-283-708	1600
6	LIRIA- VUSHTRRI	PRINTER-Xerox MFP 3100	044-647-334	1576
7	ABEDIN BUJUPI- ARLLAT	PRINTER-Xerox MFP 3100	045-263-035	1637
8	HERONJTË E DUKAGJINIT	PRINTER-Xerox MFP 3100	044-525-213	1699
9	NEDAKOC- VUSHTRRI	PRINTER-Xerox MFP 3100	044-666-939	1724
10	7 MARSII- VUSHTRRI	PRINTER-Xerox MFP 3100	044-605-694	1726
11	HIVZI SYLEJMANI	PRINTER-Xerox MFP 3100	044-274-707	1777
12	ARIF SHALA- KORROTIC	PRINTER-Xerox PE 220	044-719-645	1658
13	DËSHMORËT E FSHATIT BUBAVEC	PRINTER HP L J P2055	044-254-058	A00047
14	ISMAIL QEMALI -BELLANICË	PRINTER-Xerox 3250	044-254-615	1668
15	VELLEZERIT FRASHERI	PRINTER Xerox 3250	044-374-713	1549
16	FAIK DRAGAJ-LEÇINË	PRINTER Xerox 3250	044-934-663	A00291
17	7 MARSII -POTUROÇ	PRINTER Xerox 3250	045-243-403	1659
18	ZEJNEL SALIHU	PRINTER Xerox 3250	044-312-432	1678
19	DAUT BOGUJEVCI	PRINTER Xerox 3250	044-128-170	1651
20	DY DËSHMORËT	PRINTER Xerox 3250	044-152-082	1744
21	LISMIRI	PRINTER Xerox 3250	044-340-108	001763
22	SHABAN POLLUZHA	PRINTER Xerox 3250	044-883-392	1655
23	BAJRAM CURRI	PRINTER Xerox 3250	044 407-445	1778
24	HAMËZ JASHARI	PRINTER Xerox 3250	044-539-822	0390
25	DRENICA-POLAC	PRINTER Xerox 3250	045-463-520	0395
26	ANTON CETTA -SKENDERAJ	PRINTER Xerox 3250	044-214-163	0396

## Janar – Korrik 2018 me reshje rekorde në 15 vitet e fundit

Muajve, javëve dhe ditëve të fundit jemi dëshmitarë të anomalive të motit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike në nivel global.

Vapa që po mbretëron kësaj vere në Evropën veriperëndimore tash disa javë e që pritet të ketë kulminacionin ditëve në vazhdim me temperatura rekorde të regjistruara ndonjëherë në Evropë, deri në +50°C që pritet të ndodhin në gadishullin Iberik (Spanjë dhe Portugali), në Gadishullin Ballkanik si asnjëherë më parë ka rezultuar me sasi

rekorde reshjesh që ka reflektuar edhe me temperatura nën mesataret e pritshme.


Anomalitë në vendin tonë këtë vit kanë filluar që në muajin Prill, i cili me temperaturën mesatare prej (14.8°C) ka tejkalluar të gjitha mesataret mujore (Prill) të regjistruara që nga viti 1961, por edhe në nivel global ky muaj është shënuar si muaji Prill më i nxehtë që kur kanë filluar matjet zyrtare meteorologjike në shek. e 19-të.

Matjet e gjertanishme në Departamentin Meteorologjik në Agjencinë e Shërbimeve



të Navigacionit Ajror (ASHNA) japin një sasi totale të reshjeve për periudhën Janar – Korrik 2018 (683.5 l/m<sup>2</sup>) sasi kjo që ka tejkalluar sasi të

15 vitet e fundit, dhe madje ka tejkalluar edhe mesataren vjetore për 15 vitet e fundit (2003-2017) – 654.4 l/m<sup>2</sup>, shih tabelën:



Muajt Maj, Qershor dhe Korrik 2018, për nga sasia e reshjeve kanë shënuar vlerat rekorde që tejkalojnë dukshëm mesataret e muajve përkatës: Maj 2018 – 125.6 l/m<sup>2</sup>; mes. vjetore (Maj 2003 -2017) – 77.2 l/m<sup>2</sup>, Qershor 2018 – 188.6 l/m<sup>2</sup>; mes. vjetore

(Qershor 2003 -2017) – 76.5 l/m<sup>2</sup>, Korrik 2018 – 149.5 l/m<sup>2</sup>; mes. vjetore (Korrik 2003 -2017) – 35.5 l/m<sup>2</sup>. Madje totali i tremujorit: Maj, Qershor dhe Korrik 2018 prej 463.7 l/m<sup>2</sup> tejkallon totalin e sasisë së reshjeve vjetore për vitin 2011 – 446.7 l/m<sup>2</sup>.

Vlerat e cekura më lartë dhe rekordet e shënuara vërtetojnë dhe janë një dëshmi e fortë se ndryshimet klimatike tashmë po vërehen edhe në vendin tonë dhe përveç dëmeve të shkaktuara në fushën e agronomisë do të ndikojnë edhe në sferat e

tjera jetësore që do të detyrojnë qytetarët të ndryshojnë stilin e jetës dhe të kërkojnë mundësi për adaptim me rrethanat e reja.

Autor:  
 Sherif Gosalci -  
 Departamenti  
 Meteorologjik



## ASHNA shpërblen punëtorin e vitit z. Ramiz Latifi



Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), me rastin e përzgjedhjes së punëtorit të vitit, ka shpërblyer punëtorin z. Ramiz Latifi, me ç'rast i është dhuruar një iPhone 8.

Përzgjedhja e Prof. Ramiz Latifisi punëtor i vitit në ASHNA është bërë nga ana e Ministrisë së Administratës Publike me propozimin e ASHNA-së, me rastin e ditës Ndërkombëtare të Shërbimit Civil, e cila shënohet me datë 23 Qershor, ku me këtë rast z. Latifi i është ndarë edhe mirënjohje nga Ministri i Administratës Publike z. Mahir Yagcilar.

z. Ramiz Latifi ka qenë i punësuar më parë në cilësinë e ligjëruesit në Fakultetin e Shkencave

Matematiko-Natyrore, gjegjësisht në Departamentin e Fizikës, ndërkaq punon në ASHNA atëherë Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror (SHKTA) që nga viti 2001.

Më vonë kualifikohet si parashikues meteorologjik aeronautik dhe vrojtues meteorologjik aeronautik në procesin e përgatitjes profesionale në vitet 2002/2003. z. Latifi fillimisht në SHKTA tani ASHNA, punoi si parashikues meteorologjik aeronautik dhe më pastaj që

nga viti 2006 ushtron edhe detyrën e mbikëqyrësit për Klimatologji dhe Statistika Meteorologjike në kuadër të zyrës për klimatologji dhe statistika - Departamenti Meteorologjik.

Ndër të tjera ka zhvilluar edhe programin apo softuerin për klimatologji dhe statistika meteorologjike, një data bazë e rëndësishme në nivel vendi e të dhënave të futura në këtë program për periudhën 15 vjeçare, 2003 - 2017.

Vlen të theksohet se shumica e projektet ndërtimore, zhvillimore në vendin tone, në periudhën e pasluftës, janë furnizuar me të dhënat klimatologjike / statistikore të përpunuara nga ky program në kuadër të Zyrës për Klimatologji dhe

Statistika Meteorologjike, zyrë kjo që udhëhiqet nga Ramizi.

z. Latifi poashtu në fund të vitit 2017 ka zhvilluar dhe modifikuar metodën McKenzie me të dhënat e mbledhura për 15 vite, metodë kjo efikase për parashikimin e temperaturës minimale, e rëndësishme kjo për kushtet e dimrit për planifikimin e mirëmbajtjes së hapësirave manovruese aeroportuale dhe për de-akullzimin e fluturakeve.

Ramiz Latifi që nga fillimi i angazhimit në ASHNA njihet si një punëtor i devotshëm dhe përkushtuar në disiplinë, respektimin e rregullativës ekzistuese, komunikativ, gjithnjë me qasje proaktive dhe me ide të qarta në dobi të përgjithshme të kolektivit.



## SINKON pjesëmarrëse në punëtorinë e organizuar në Vjenë të Austrisë

Shoqata Sindikale e Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Kosovës (SINKON), mori pjesë në një punëtorinë për Promovimin e dialogut mes menaxhmentit dhe Kontrollorëve të Trafikut Ajror. Punëtorja ishte tre ditore dhe u mbajti në Vjenë të Austrisë nga data 01 deri më 03 tetor, nën organizimin e Air Traffic Controllers European Unions Coordination (ATCEUC) dhe sponsorizuar nga DG MOVE (Drejtoria e Aviacionit në Komisionin Evropian).



Gjatë punëtorisë "Komunikimi mes Kontrollorëve të Trafikut Ajror dhe Menaxhmentit"

Në këtë punëtori, ku Kosova u përfaqësua nga Kryetari i SINKON Artan Hasani, temë diskutimi ishte

promovimi i dialogut në mes menaxhmentit dhe kontrollorëve të trafikut ajror, me qëllim të shmangies së grevave

dhe veprimeve të njëanshme të secilës palë të përfshirë. Mes tjerash, temë e diskutimit ishte edhe promovimi i veglës

së kulturës së drejtë (ang. Just culture toolbox).

Kosova u bë pesë e kësaj punëtorie me ftesë të ATCEUC ku edhe udhëtimi i Kryetarit të SINKON Artan Hasani ishte i sponsorizuar nga Komisioni Evropian, DG Move (Drejtoria për aviacione KE), me gjithë faktin që Kosova nuk është anëtare e BE-së.

Qëllimi i nikoqirit të kësaj punëtorie, përmes pjesëmarrjes së Kosovës, saktësisht përmes pjesëmarrjes së Z. Hasanit, edhe Kosova të përfitojë njohuri se si zhvillohet procesi i dialogut social në Bashkimin Evropian.

## Raporti Special për Ndryshimet Klimatike 2018



**Autorial nga:  
Sabit Gashi**

Paneli nderqeveriter për Ndryshime Klimatike i OKB-së (IPCC) më 8 tetor në Kore miratoi

Raportin Special (SR15) për kufizimet e ngrohjes globale në limitin e rritjes për 1.5°C. Përveq që ky raport do të ketë rëndësi të madhe shkencore; do ta rrisë edhe e rëndësisë e Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike.

Kufizimi i ngrohjes globale në 1.5°C do të kërkonte një shpejtësi të madhe dhe ndryshime të

pashembullta në të gjitha aspektet e shoqërisë, - thuhet në këtë raport. Ky kufizim në 1.5°C në krahasim me kufizimin e mëparshëm në 2°C siguron një shoqëri me zhvillim të qëndrueshëm.

SR1.5 përmbanë mbi 6000 referenca shkencore, kontributin e mijëra ekspertëve dhe rishikuesve të qeverive;

për më tepër dëshmon për gjerësinë dhe rëndësinë e politikave të IPCC.

Afër njëqind autorë dhe redaktorë rishikues nga 40 vende përgatitën raportin me kërkesën e Kornizës së Ndryshimeve Klimatike së KB-së (UNFCCC), që kur u miratua Marrëveshja e Parisit e vitit 2015.

Një nga mesazhet kyçe



nga ky raport është se tashmë po shihen pasojat e rritjes së temperaturës globale prej 1°C të shprehura përmes motit më ekstrem, përmes rritjes së nivelit të detit dhe përmes ndryshimeve të tjera. Raporti përmendë disa ndikime të ndryshimeve klimatike që mund të shmangen nëse limitojmë ngrohjen në 1.5°C në krahasim me 2°C (ose edhe më shumë). Ngrohja prej 1,5 °C (ose më e lartë) do të kishte impakte afatgjata (ose të pakthyeshme). Ky limitim gjithashtu do t'i mundësonte njerëzve dhe ekosistemeve mundësi për t'u përshtatur. Raporti gjithashtu shqyrton rrugët në dispozicion për të realizuar këtë limit të temperaturës globale të planetit. Tashmë është Standard se kudo nëpër botë disa nga llojet e veprimeve që

e limitojnë këtë ngrohje janë në process e sipër, dhe IPCC sugjeron përshejtimin e tyre. Limitimi i temperaturës do të kërkonte; kalime të shpejta dhe të gjera në trajtimin në tokë, energji, industri, ndërtesa, transport, etj. Emetimi i gazit serë CO<sub>2</sub> duhet zvogëluar 45% nga nivelet e 2010 deri në vitin 2030, dhe ta arrinë emetimin në zero rreth vitit 2050, dhe për arrijtjen e këtij targeti çdo emetim duhet të balancohet me tërheqjen e tij nga ajri. Ky raport u jep politikëbërësve dhe praktikuesve informacionin që ata kanë nevojë për të marrë vendime që lidhen me ndryshimet klimatike duke marrë parasysh kontekstin lokal dhe nevojat e njerëzve. "Nëse krijohen kushtet që temperatura globale të tejkalohet apo

përkohësisht të tejkalohet mbi vlerën 1.5°C, nënkuptojmë se duhet të mbështetemi në teknikat që nga ajri largojnë gazin serë CO<sub>2</sub> në mënyrë që të zvogëlohet sërish temperatura globale nën rritjen prej 1.5 °C rreth vitit 2100. Efekti i teknikave të tilla në një shkallë të gjërë nuk është vërtetuar prandaj mund të sjellë një risk për zhvillimin e qëndrueshëm" - thotë raporti special i IPCC-së. Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) është organi i OKB-së për vlerësimin e shkencës në lidhje me ndryshimet klimatike. U krijua nga Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara (UNEP) dhe nga Organizata Botërore Meteor-

ologjike (WMO). Vlerësimet e IPCC-së i furnizojnë qeveritë në të gjitha nivelet me informacione shkencore me qëllim që t'i përdorin për zhvillimin e politikave klimatike, për vlerësimin vulnerabilitetit, zbutjes dhe adaptimin nga Ndryshimet Klimatike. IPCC është panel legal aktiv me seli në Gjenevë formuar në vitin 1988.



## IMPRESSUM

**Redaktor: Driton Ujkani**

**Kontribuan: Alban Sylaj; Sherif Gosalci; Artan Hasani; Sabit Gashi**

*Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
Vrellë, Lypjan, 10070,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 (0) 38 59 58 641  
E-mail: info.ashna@rks-gov.net  
web: www.ashna-ks.org*

